



**Trepça sh.a.**

Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg  
Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë

**Pasqyrat Financiare dhe Raport i Auditorëve të pavarur 31 Dhjetor 2020**



Përmbajtja:

Raport i auditorëve të Pavarur.. .....	3
Bilanci i Gjendjes.....	10
Pasqyra e te Ardhurave dhe Shpenzimeve.....	11
Pasqyra e Rrjedhës së Parasë.....	12
Pasqyra e Ndryshimeve në Ekuitet.....	13
Shënimet e pasqyrave financiare.....	14-28

## **RAPORT I AUDITUESIT TË PAVARUR**

**Drejtuar: Menaxhmentit dhe Aksionarit te "Trepça" sh.a**

### **Raport mbi Pasqyrat Financiare**

#### **Mohim i Opinionit**

Ne nuk shprehim një opinion mbi pasqyrat financiare përcjellëse të kompanisë. Për shkak të rëndësisë së çështjeve të trajtuara në seksionin Bazat për Mohim të Opinionit të raportit tonë, ne nuk kemi qenë në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi të përshtatshme për të siguruar një bazë për një opinion të auditimit për këto pasqyrat financiare.

Ne kemi qenë të angazhuar për te audituar pasqyrat financiare të ndara te njërive Miniera me Flotacion Trepça - Stan Tërg dhe Miniera me Flotacion Kishnicë dhe Artanë te bashkëngjitura të Trepça sh.a (në vijim referuar si "Kompania" apo Trepça) të cilat përfshijnë pasqyrën e pozicionit financiar të datës 31 dhjetor 2020, pasqyrën e të hyrave gjithëpërfshirëse, pasqyrën e rrjedhës së parasë dhe pasqyrën e ndryshimeve në ekuitet për vitin e mbyllur në këtë datë dhe një përmbledhje të politikave të rëndësishme kontabël si dhe informacionin tjetër shpjegues te përfshirë ne fq. 10-28.

#### **Baza për mohim të opinionit**

1. Siç është shpalosur më tej në Shënimin 4 të pasqyrave financiare përcjellëse, më 31 Dhjetor 2020 përfshirë në totalin e Pronës, Impianteve dhe Pajimeve të Kompanisë, vlera e aseteve është 150,236,748 euro (31 Dhjetor 2019; 150,528,980 euro). Duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban organizata, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të Pronës, Impianteve dhe pajimeve të kompanisë më 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019. Kompania ka rivlerësuar vlerën e tokës të përfshirë ne Prone, Impiante dhe Pajime ne shumën 148,343,937 EUR me 31 Dhjetor 2020 (31 Dhjetor 2019; 148,343,937 EUR), ne mungese te dokumentacionit mbështes ne nuk ishim ne gjendje te përcaktojmë saktësinë e vlerësimit të kryer dhe as te marrim siguri te mjaftueshme mbi vlerën bartëse te tokës me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019. Po ashtu kompania nuk ka një metode konsistente ne lidhje me kapitalizmin e shpenzimeve dhe zhvlerësimin e tyre

Për me tepër, ka indikacione që asetet e kompanisë duhet të zhvlerësohen tutje për shkak se Kompania vazhdon të operon me humbje dhe operimi i saj është i varur nga mbështetja financiare prej aksionarit, gjithsesi Kompania nuk ka kryer testimin e dëmtimit të aseteve ashtu siç kërkohet me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit 36 Dëmtimi i aseteve dhe nuk ka njohur ndonjë shpenzim në lidhje me dëmtimin e aseteve. Prandaj ne prap nuk ishim ne gjendje te përcaktonim shume e nevojshme te korrigjimit ne lidhje me vlerën bartëse te pronës, Impianteve dhe Pajimeve dhe efektin e këtyre korrigjimeve ne pasqyrat financiare përcjellëse.

2. Siç paraqitet në shënimin 5 të pasqyrave individuale financiare, vlera e inventarëve të Kompanisë me 31 dhjetor 2020 është 2,592,001 (31 Dhjetor 2019; 1,430,250 euro). Ne jemi emëruar si auditor pas fundit të vitit dhe nuk kemi marrë pjesë në numërimin fizik të materialeve të para dhe stoqeve të Kompanisë me 31 dhjetor 2020. Ne nuk ishim në gjendje të fitonim siguri të arsyeshme me procedura alternative në lidhje me sasi të inventarit gjendje më 31 dhjetor 2020, si rezultat, nuk jemi në gjendje të përcaktojmë shumën e ndonjë korigjimi të mundshëm në lidhje inventarët e Kompanisë më 31 dhjetor 2020 dhe efektet që do të kishte në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

Për me tepër, gjate auditimit ton ne kemi vërejtur që stoqet në Kontabilitet nuk udhëhiqen në mënyrë konsistente, saldo e stoqeve regjistrohet vetëm me numërim të fund vitit përderisa gjate të vitit nuk regjistrohen fletëdaljet, po ashtu kompania nuk ka kryer ndonjë vlerësim për dëmtim të vlerës së stoqeve dhe nuk ka njohur ndonjë provizion për stoqe të vjetruara, prandaj ne prape nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të përcaktojmë vlerën e stoqeve më 31 Dhjetor 2020. Po ashtu kompania ka kryer një vlerësim të vlerës së stoqeve duke rritur vlerën e tyre, ne nuk ishim në gjendje duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të përcaktojmë nëse ky vlerësim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

3. Siç paraqitet në shënimin 6 të pasqyrave individuale financiare, vlera e pjesëve rezerve - inventarit të Kompanisë me 31 dhjetor 2020 është 2,697,838 (31 Dhjetor 2019; 0 euro). Ne jemi emëruar si auditor pas fundit të vitit dhe nuk kemi marrë pjesë në numërimin fizik të pjesëve rezerve / inventarit të Kompanisë me 31 dhjetor 2020. Ne nuk ishim në gjendje të fitonim siguri të arsyeshme me procedura alternative në lidhje me sasi dhe vlerën e pjesëve rezerve / inventarit më 31 dhjetor 2020, si rezultat, nuk jemi në gjendje të përcaktojmë shumën e ndonjë korigjimi të mundshëm në lidhje inventarët e Kompanisë më 31 dhjetor 2020 dhe efektet që do të kishte në pasqyrën individuale të të ardhurave gjithëpërfshirëse për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2020.

Për me tepër, gjate auditimit ton ne kemi vërejtur që pjesët rezerve të inventarit në Kontabilitet nuk udhëhiqen në mënyrë konsistente, kjo saldo e inventarit është regjistruar për here të pare me 31 Dhjetor 2020 dhe Kompania nuk ka kryer ndonjë regjistrim korigjues për vitet paraprake, prandaj ne prape nuk ishim në gjendje, duke aplikuar procedurat standarde dhe alternative të auditimit, të përcaktojmë vlerën e pjesëve rezerve të inventarit më 31 Dhjetor 2020 apo shumën e korigjimeve të nevojshme dhe efektin e tyre në pasqyrat financiare përcjellëse.

4. Siç është shpalosur më tej në Shënimin 7 të pasqyrave financiare përcjellëse, më 31 Dhjetor 2020 përfshirë në totalin e të arkëtueshmeve tregtare dhe të tjera të Kompanisë, bilanci i të arkëtueshmeve tregtare është 2,379,638 euro (31 Dhjetor 2019; 1,329,188 euro). Ne mungese të konfirmimeve nga blerësit dhe duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e këtyre llogarive janë të vjetruara dhe Kompania nuk ka njohur ndonjë provizion për borxhe të këqija, ne nuk ishim në gjendje të arrijmë një siguri të arsyeshme për vlerën bartëse neto të të arkëtueshmeve tregtare të kompanisë më 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019.
  
5. Siç është shpalosur në shënimin 10 të pasqyrave financiare shoqëruese, bilanci i të hyrave të shtyra nga grantet qeveritare më 31 dhjetor 2020 është 1,003,082 euro (31 Dhjetor 2019; 2,012,346 euro) . Duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban Kompania, ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi rreth vlefshmërisë dhe plotësisë së të hyrave të shtyra nga grantet më 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 apo efektin e korigjimeve të mundshme në pasqyrat financiare përcjellëse.
  
6. Siç është shpalosur në shënimin 11 të pasqyrave financiare shoqëruese, bilanci i të pagueshmeve tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2020 arrin shumën në 5,236,270 euro (31 Dhjetor 2019; 3,625,298 euro) . Ne mungese të konfirmimeve nga furnitorët dhe duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban Kompania, ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi rreth vlefshmërisë dhe plotësisë së të pagueshmeve tregtare dhe të tjera më 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 apo efektin e korigjimeve të mundshme në pasqyrat financiare përcjellëse.
  
7. Siç është prezantuar në Pasqyrën e Pozitës Financiare, bilanci i të hyrave të shtyra më 31 dhjetor 2020 arrin shumën në 458,135 euro (31 Dhjetor 2019; 866,846 euro). Ne mungese të qasjes në dokumentet e shitjes dhe konfirmimeve të pavarura nga blerësit, ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi rreth vlefshmërisë dhe plotësisë së të hyrave të shtyra më 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 apo efektin e korigjimeve të mundshme në pasqyrat financiare përcjellëse.
  
8. Siç është shpalosur në shënimin 12 të pasqyrave financiare shoqëruese, bilanci i detyrimeve për përfitimet ndaj punonjësve më 31 dhjetor 2020 arrin shumën në 4,286,251 euro (31 Dhjetor 2019; 0 euro) . Duke pasur parasysh natyrën e shënimeve që mban Kompania, ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi rreth vlefshmërisë dhe plotësisë së këtyre detyrimeve më 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 apo efektin e korigjimeve të mundshme në pasqyrat financiare përcjellëse. Për më tepër, këto detyrime, edhe pse saldo të bartura nga vitet e mëhershme, nuk janë prezantuar më 31 Dhjetor 2019.

9. Siç është prezantuar ne Pasqyrën e Pozitës Financiare, bilanci i detyrimeve për rentën minerale më 31 dhjetor 2020 arrin shumën në 7,545,927 euro (31 Dhjetor 2019; 797,642 euro) . Ne mungese te konfirmimeve te pavarura nga Institucionet përkatëse dhe duke pasur parasysh natyrën e shënimeve qe mban Kompania, ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi rreth vlefshmërisë dhe plotësisë së këtyre detyrimeve më 31 dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 apo efektin e korrigjimeve te mundshme ne pasqyrat financiare përcjellëse. Për me tepër, këto detyrime, edhe pse saldo te bartura nga vitet e mëhershme, nuk janë prezantuar me 31 Dhjetor 2019.
10. Siç është shpalosur në shënimin 15 të pasqyrave financiare shoqëruese, te hyrat nga shitja për vitin qe përfundon më 31 dhjetor 2020 janë 8,039,144 euro (31 Dhjetor 2019; 9,056,244 euro). Ne nuk kemi pasur qasje ne kontratat e shitjes pasi Kompania te njëjtat i ka konsideruar konfidenciale, për pasoj ne nuk ishim ne gjendje te merrnim siguri te mjaftueshme rreth ndodhjes, plotësisë dhe saktësisë se njohjes se te hyrave, apo efektit te korrigjimeve te mundshme ne pasqyrat financiare përcjellëse.
11. Siç është shpalosur në shënimin 16 të pasqyrave financiare shoqëruese, kosto e mallrave te shitur për vitin qe përfundon më 31 dhjetor 2020 është 13,626,376 euro (31 Dhjetor 2019; 1,459,957euro). Kompania nuk ka ndonjë politike te shkruar rreth kategorizimit te kostove si kosto e shitjes dhe për me tepër nuk ka konsistencë ne njohjen e te njëjtës përgjatë viteve raportuese duke humbur kështu krahasueshmerin e kostove te njohura. Prandaj, duke pasur parasysh natyrën e shënimeve qe mban Kompania, ne nuk ishim në gjendje të sigurohemi rreth saktësisë dhe plotësisë së njohjes se koston se mallit te shitur me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019, apo efektit te korrigjimeve te mundshme ne pasqyrat financiare përcjellëse.
12. Siç është shpalosur në shënimin 2.1 të pasqyrave financiare shoqëruese, pasqyrat financiare janë përgatitur mbi parimin vazhdimësisë. Kompania është aktualisht shumë e varur nga të ardhurat nga grantet për t'i mundësuar asaj vazhdimin e funksionimit. Këto pasqyrat financiare supozojnë se mbështetje e mjaftueshme financiare do të merret nga qeveria e Kosovës për të mundësuar Kompaninë të vazhdoj operimet e saj, nese kjo nuk ndodh atëherë vazhdimësia e operimeve te Kompanisë është e pa sigurte.
13. Pasqyrat financiare përcjellëse me dhe për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 nuk përmbajnë te gjithë informacionin shpjegues te kërkuar me Standardet Ndërkombëtare te Raportimit Financiar dhe prezantimi i te njëjtave nuk është ne përputhje te plote me Standardin Ndërkombëtar te Kontabilitetit 1 Prezantimi i Pasqyrave Financiare. Si rezultat i kësaj ne nuk ishin në gjendje për të marrë dëshmi të mjaftueshme dhe përkatëse të auditimit për dhënien e informacioneve shpjeguese të tilla të kërkuara nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020. Si pasojë, ne nuk

ishin në gjendje për të përcaktuar nëse ndonjë rregullim i këtyre shpalosjeve do të ishte i nevojshëm.

14. Kompania nuk ka njohur ndonjë aset apo detyrim të tatimit të shtyrë dhe në të njëjtën kohë as shpenzim apo fitim të tatimit të shtyrë në pasqyrat e saj financiare për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020 ashtu siç kërkohet me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit numër 12 “Tatimet në të Ardhura”. Ne mungese të procedurave alternative të auditimit ne nuk ishim në gjendje të përcaktojmë nivelin e korigjimeve, nëse do kishte pasur, të cilat do të kishin qene të nevojshme me qëllim të regjistrimit të tatimeve në përputhje me Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit numër 12 “Tatimet në të Ardhura”.
15. Gjatë auditimit ton ne kemi vërejtur se ndaj Kompanisë janë ushtruar disa padi. Kompania nuk ka njohur ndonjë provizion për rastet gjyqësore për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020 dhe 31 Dhjetor 2019 ashtu siç kërkohet me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar prandaj ne nuk ishim në gjendje të vlerësonim nëse ndonjë rregullim është i nevojshëm për tu bërë në pasqyrat financiare përcjellëse.

#### **Çështjet e theksuara**

Duke mos e kualifikuar me tutje mendim tone, ne tërheqim vëmendjen si më poshtë:

- i) Siç është shpalosur në shënimin 16 të pasqyrave financiare përcjellëse, librat dhe regjistrimet tatimore të Kompanisë nuk janë audituar nga Autoriteti tatimor për vitin që përfundon që 31 Dhjetor 2020 dhe 2019. Si rrjedhojë e kësaj, detyrimet tatimore të Kompanisë nuk mund të konsiderohen të finalizuara. Provizionet për taksat shtesë dhe gjrobat, nëse ka ndonjë, nuk mund të përcaktohen me ndonjë saktësi të arsyeshme, në këtë fazë.
- ii) Siç është shpalosur në shënimin 1 të pasqyrave të ndara financiare përcjellëse, këto pasqyra financiare prezantojnë vetëm pozicionin financiar të njërive Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg dhe Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë të Trepçës e cila administrohet në Jug të Mitrovicës dhe jo të Ndërmarrjes Trepça SHA në tërësi.

Opinionin jonë nuk është modifikuar në lidhje me çështjet e detajuara në paragrafin i

#### **Çështje tjera**

Pasqyrat financiare të Kompanisë me dhe për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2019 janë audituar nga një auditor tjetër i cili nuk shprehu opinion për pasqyrat financiare.

**Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për Pasqyrat Financiare**

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe për ato kontrole të brendshme që menaxhmenti i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së kompanisë për të vazhduar aktivitetin e saj (parimi i vijimësisë), shpalosjen, sipas rastit, të çështjeve që lidhen me parimin e vijimësisë dhe përdorimin bazës së kontabilitet sipas parimit të vijimësisë përveç nëse menaxhmenti synon të likuideojë Kompaninë ose të ndërpresë operacionet, ose nuk ka asnjë alternativë realiste përveç për ta bërë këtë.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të kompanisë.

#### **Përgjegjësitë e auditorit për auditimin e Pasqyrave Financiare**

Përgjegjësia jonë është të kryejmë një auditim të pasqyrave financiare të Kompanisë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit dhe të lëshojmë një raport të auditorit. Sidoqoftë, për shkak të çështjeve të përshkruara në pjesën e Bazës për Mohim të Opinionit të Raportit tonë, ne nuk ishim në gjendje të merrnim sa duhet evidencat e duhura të auditimit për të siguruar një bazë për një opinion auditimi mbi këto pasqyra financiare.

#### **Informatat tjera**

Informatat tjera përfshijnë Raportin e menaxhmentit, se bashku me një Deklaratë të qeverisjes Korporative të Kompanisë ashtu siç kërkohet nga neni 7 i Ligjit nr. 06/L-032 për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim përbejnë pjesë të veçantë të raportit për vitin financiar që përfundon me 31 Dhjetor 2020.

#### **Përgjegjësia e menaxhmentit dhe e atyre të ngarkuar me qeverisje për informatat tjera**

Menaxhmenti i kompanisë është përgjegjës për informatat tjera. Informatat tjera përfshijnë raportin e menaxhmentit të përfshirë në raportin vjetor.

#### **Përgjegjësitë e auditorit**

Mendimi ynë për pasqyrat financiare nuk përfshin informacione të tjera dhe, përveç në masën e deklaruar në mënyrë të shprehur në raportin tonë, ne nuk shprehim ndonjë konkluzion sigurie në të.

Në lidhje me auditimin tonë të pasqyrave financiare, përgjegjësia jonë është që të lexojmë informacionin tjetër, dhe duke vepruar kështu, të konsiderojmë nëse informacioni tjetër nuk është materialisht në kundërshtim me pasqyrat financiare ose me njohuritë tona të marra në auditim.

Në lidhje me raportin e menaxhmentit ne kemi marrë parasysh nëse ai përfshin shpalosjen e kërkuar nga Ligji Nr. 06 / L-032 për Kontabilitetin, Raportimin Financiar dhe Auditimin, Neni 10.

Bazuar, vetëm në punën që kërkohet të bëhet gjatë auditimit të pasqyrave financiare dhe procedurave të mësipërme sipas mendimit tonë:

#### **Opinionit mbi raportin e Menaxhmentit**

Bazuar ne punën tonë te kryer gjate auditimit, opinionit jone është se raporti i Menaxhmentit:

- nuk është përgatitur në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, neni 10 dhe

#### **Opinionit mbi Deklaratën e Qeverisjes Korporative**

Në opinionin tonë, Deklarata e Qeverisjes Korporative te Kompanisë përmban te gjitha informacionet siç kërkohet nga neni 7 i ligjit dhe është ne përputhje me informacionin e përfshirë ne pasqyrat financiare.

#### **Raport mbi kërkesat tjera ligjore dhe rregullative**

##### **Deklaratë në lidhje me ofrimin e shërbimeve jo te auditimit**


Në më të mirën e njohurive dhe besimit tonë, ne sigurojmë që nuk kemi ofruar asnjë shërbim jo-auditues të cilat janë të ndaluara në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019 për Pavarësinë e Auditorëve Ligjorë dhe Firmave te Auditimit.

##### **Emërimi i auditorit**

Ne u emëruam si Auditor të Pasqyrave financiare te Kompanisë me 01 Shkurt 2021 përmes një procesi te tenderimit publik. Ne konfirmojmë se nga këndvështrimi i Ligjit Nr. 06 / L-032 për kontabilitetin, raportimin financiar dhe auditimin, ky është viti i parë qe ne po ofrojmë shërbime të auditimi për pasqyrat financiare te Kompanisë.

28 Maj 2021

Audit&Conto sh.p.k

  
Ymer Shatri

Partner Angazhimi



Trepça – Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë

Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020

## Pasqyra e Pozitës Financiare

	Shënimi	31 Dhjetor 2020	31 Dhjetor 2019
<b>PASURITË</b>			
<b>Pasuritë afatgjata</b>			
Prona, pajisjet dhe impiantet	4	150,236,748	150,528,980
Investimet në vijim			99,999
<b>Gjithsej pasuritë afatgjata</b>		<b>150,236,748</b>	<b>150,628,979</b>
<b>Pasuritë afatshkurtra</b>			
Stoqet	5	2,592,001	1,430,250
Inventarët (pjesë rezervë)	6	2,697,837	
Llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	7	2,379,638	1,329,188
Pasuritë e tjera afatshkurtra			248,222
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	8	197,189	37,236
<b>Gjithsej pasuritë afatshkurtra</b>		<b>7,866,665</b>	<b>3,044,896</b>
<b>Gjithsej pasuritë</b>		<b>158,650,566</b>	<b>153,673,875</b>
<b>EKUITETI DHE DETYRIMET</b>			
<b>EKUITETI</b>			
Kapitali aksionar	9	163,058,866	163,058,866
Fitimet (Humbjet) e mbajtura	9	(18,207,708)	(14,741,024)
Humbja e vitit		(4,730,257)	(3,466,684)
<b>Gjithsej ekuiteti</b>		<b>140,120,901</b>	<b>144,851,158</b>
<b>DETYRIMET</b>			
<b>Detyrimet afatgjata</b>			
Detyrimet e shtyra Grantet	10	1,003,082	2,012,346
<b>Gjithsej detyrimet afatgjata</b>		<b>1,003,082</b>	<b>2,012,346</b>
<b>Detyrimet afatshkurtra</b>			
Llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	11	5,236,270	3,625,298
Tatimet e pagueshme aktuale			1,415,031
Të hyrat e shtyra		458,135	866,846
Detyrimet ndaj Lizingut financiar			104,554
Përfitimet e punonjësive të pagueshme	12	4,286,251	
Detyrimet e për rentën minerare		7,545,927	797,642
<b>Gjithsej detyrimet afatshkurtra</b>		<b>17,526,583</b>	<b>6,810,371</b>
<b>Gjithsej detyrimet</b>		<b>18,529,665</b>	<b>8,822,717</b>
<b>Gjithsej ekuiteti dhe detyrimet</b>		<b>158,650,566</b>	<b>153,673,875</b>

Këto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Kompanisë më 31 Mars 2021 dhe nënshkruar nga

Ztr. Rafet Ibishi  
UD.Kryeshef Ekzekutiv

Znj. Hafije Zeqiri  
UD. ZKTHF

Znj. Fitore Munishi  
Kontabilist I Certifikuar

Trepça – Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë

Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020

## Pasqyra e të hyrave gjithëpërfshirëse

	Shënimi	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2020	Për vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019
Të hyrat			
Te hyrat nga shitja	13	8,039,144	9,056,244
Kosto e shitjes	15	14,316,552	1,459,957
<b>Fitimi/(humbja) bruto</b>		<b>(6,277,408)</b>	<b>7,596,287</b>
Të ardhurat tjera	14	6,326,208	3,355,779
Shpenzimet e stafit	16	(2,555,295)	(12,313,654)
Shpenzimet administrative	17	(424,244)	(1,714,710)
Shpenzimet tjera	18	(1,693,178)	(2,311,876)
<b>Fitimi/(humbja) operativ</b>		<b>(4,623,917)</b>	<b>(5,388,174)</b>
Shpenzimet financiare	19	(106,340)	(90,856)
Të ardhurat financiare			2,012,346
<b>Fitimi / (humbja) para tatimit</b>		<b>(4,730,257)</b>	<b>(3,466,684)</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	20		-
<b>Fitimi / (humbja) neto i/e vitit</b>		<b>(4,730,257)</b>	<b>(3,466,684)</b>
Te ardhurat tjera gjithëpërfshirëse: Diferenca kembimore nga përkthimi i valutave Financiare te operacioneve te huaja, neto nga tatimi			
<b>Gjithsej te ardhurat/(humbjet) gjithëpërfshirëse për vitin</b>		<b>(4,730,257)</b>	<b>(3,466,684)</b>

Trepça – Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë

Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020

## Pasqyra e ndryshimeve ne ekuitet

	Kapitali aksionar	Fitimet e mbajtura	Gjithsej
<b>Gjendja më 1 janar 2019</b>	22,808,174	(14,741,024)	8,067,150.00
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	(3,466,684)	(3,466,684)
Deponimet e kapitalit shtesë	140,250,692	-	140,250,692
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	<b>163,058,866</b>	<b>(18,207,708)</b>	<b>144,851,158</b>
<b>Gjendja më 1 janar 2020</b>	163,058,866	(18,207,708)	144,851,158
Fitimi / (humbja) i/e vitit	-	(4,730,257)	(4,730,257)
<b>Diferenca nga përkthimet valutore</b>			
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2020</b>	<b>163,058,866</b>	<b>(22,937,965)</b>	<b>140,120,901</b>

**Trepça – Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë**

**Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020**

## **Pasqyra e rrjedhës së parasë**

	<b>2020</b>	<b>2019</b>
Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative		
Fitimi / (humbja) i / e vitit	(4,730,257)	(3,466,648)
Zhvlerësimi i pronës, pajisjeve dhe impianteve	939,385	769,654
Të ardhurat financiare		2,012,346
Shpenzimet financiare	(106,340)	(90,856)
<b>Rrjedha e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>(3,897,212)</b>	<b>(775,540)</b>
Ndryshimet në pasuritë dhe detyrimet operative		
(Rritja) / zvogëlim në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(1,050,450)	170,469
(Rritja) / zvogëlimi në stoqe	(1,161,751)	(691,850)
(Rritja) / Zvogëlimi në pasuri tjera	(2,697,837)	
Rritja / (zvogëlimi) në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	9,007,399	3,310,354
Interesi I paguar	(34,013)	
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet operative</b>	<b>166,136</b>	<b>91,943</b>
Rrjedha e parasë nga aktivitetet investuese		
Pagesat për blerjet e pronës, pajisjeve dhe impianteve	(1,003,082)	755,913
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet investuese</b>	<b>(1,003,082)</b>	<b>755,913</b>
Rrjedha e parasë nga aktivitetet financuese		
Deponimet e kapitalit shtesë		
Pagesat e lizingut financiar	(1,009,264)	(1,786,886)
<b>Rrjedha neto e parasë nga aktivitetet financuese</b>	<b>(1,009,264)</b>	<b>(1,786,886)</b>
<b>Rritja/(zvogëlimi) neto i parasë dhe ekuivalentëve të parasë</b>	<b>159,953</b>	<b>(939,030)</b>
Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fillim të vitit	37,236	793,149
<b>Paraja dhe ekuivalentët e parasë në fund të vitit</b>	<b>197,189</b>	<b>37,236</b>

## **1. Të Përgjithshme**

Trepça; Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë operon si njësi organizative në kuadër të kompanisë Trepça Sha , Numri unik identifikues: 810356932, me NRB 70331094 dhe NF 600141543. Selia e kësaj Njësie Organizative është ne Mitrovicë, Parku Industrial .

Aktiviteti kryesor i biznesit është eksplorimi, shfrytëzimi, nxjerrja dhe përpunimi i xehes se plumbit dhe zinkut.

Trepça SHA në tërësinë e këtij raporti sajë përfshin dy njësi të mëdha të prodhimit si më poshtë:

- Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg
- Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë;

Si një prodhim përfundimtar i produktit dhe përpunimit për shitje si produkt i gatshëm për treg është shitja e koncentreve të plumbit dhe zinkut dhe në një masë më të vogël te plumbit, për shkak të pamundësisë të përpunimit përfundimtar, kështu që këto gjysëm- produkte konsiderohen si produkte të gatshme dhe trajtohen si finale.

Kompania deri ne muajin tetor 2016 ka qën nën administrimin e AKP-së përderisa nga tetori 2016 e tutje ka kaluar ne Kompani Publike me miratimin e ligjit Nr. 05/L -120 për Trepçën. Kompania gjendet ne proces te ristrukturimit, Njësia e Trepçës ne jug te Mitrovicës të udhëhiqet nga menaxheri i njësisë organizative.

Trepça Sh.A. është shoqëri aksionare në pronësi 80% të Qeverisë dhe 20 % të punëtorëve sipas nenit 4 të ligjit Nr. 05/L -120;

Bazuar ne ligjin Nr. 05/L -120 për Trepçën, neni 2.3 Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg (Fi 690/89) dhe Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë (Fi 349/88); janë njësi biznesore e Trepçës Sha

Kompania është kategorizuar si një kompani e madhe sipas klasifikimit adekuat te rregullativës ligjore.

Numri i të punësuarve me 31 Dhjetor 2020 është 1372 punëtorë.

Trepça njësia ne jug te Mitrovicës, minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg dhe minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë, operojn plotesisht te ndara nga njesia veriore e saj në praktikë, përderisa të tria njësitë janë te regjistruara si një biznes i vetëm.

Ky raport financiar prezanton pozitën financiare dhe transaksionet e ndodhura gjatë vitit vetëm për njësitet Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg (Fi 690/89) dhe Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë (Fi 349/88), dhe jo të Trepçës sh.a në tersi.

## **2. Politikat e kontabilitetit**

Në vijim janë politikat themelore të kontabilitetit të adoptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

### **2.1 Bazat e përgatitjes**

Këto pasqyra janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF). Pasqyrat financiare janë përgatitur nën marrëveshjen e kostos historike, ndërsa e modifikuar për paraqitjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve në shumat e rivlerësuara sikurse janë të përshkruara tutje në këtë shënim.

Këto pasqyra janë përgatitur nën pohimin se Kompania do të vazhdojë vijueshmërinë e saj se paku në 12 muajt e ardhshëm.

Operacionet e Kompanisë janë të varura dhe të mbështetura nga grantet e dhëna nga aksionari. Menaxhmenti i konsideron të mjaftueshme fondet e jashtme që do të jenë të mundshme në të ardhmen të cilat do ti mundësojnë Kompanisë pagesën e borxheve të tyre me kohë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në përputhje me IFRS-të kërkon nga menaxhmenti të bëjë vlerësimet dhe parashikimet të cilat ndikojnë në shumat e raportuara të aseteve dhe detyrimeve dhe shpalosjet e pasurive dhe detyrimeve kontingjente në datën e pasqyrës financiare dhe shumat e raportuara të të ardhurave dhe shpenzimeve përgjatë periudhës së raportuar. Këto vlerësime janë bazuar në informatat e disponueshme në datën e pasqyrave financiare. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Këto pasqyra financiare janë përgatitur për vitin që përfundon më 31 Dhjetor 2020. Të gjitha të dhënat janë të shfaqura në euro vetëm nëse nuk qëndron ndryshe.

### **2.1 Monedhat e huaja**

Transaksionet në monedha të huaja fillimisht regjistrohen në monedhën aktuale pastaj konvertohen me kursin e këmbimit në datën e kryerjes së transaksioneve. Vlerat e Aseteve dhe detyrimeve në monedha të huaja janë konvertuar duke përdorur kursin e këmbimit në datat e bilancit të gjendjes. Fitimet dhe humbjet e ndodhura nga shkëmbimet valutore paraqiten në pasqyrën e të Ardhurave dhe shpenzimeve.

## **2.Politikat e kontabilitetit (vazhdim)**

### **2.2 Prona, Impiantet dhe pajimet**

Zërat e pronës, impianteve dhe pajisjeve ekzistuese të blera-furnizuara apo ndërtuara pas vitit 2001 janë paraqitur sipas kostos së blerjes së tyre, minus zhvlerësimi i akumuluar pasues. E gjithë prona, impiantet dhe pajisjet tjera janë paraqitur sipas kostos zbritur për zhvlerësimin e akumuluar. Kosto paraqet shpenzimet që i atribuohen direkt përvetësimin të njësisve (zërave). Kostot pasuese janë përfshirë në vlerën bartëse të aseteve apo janë njohur si asete të veçanta, siç ka qene me e përshtatshme, vetëm atëherë kur përfitime ekonomike të mundshme lidhur me këtë mund të rrjedhin në Kompani dhe kostoja e mjetit mund të matet besueshëm. Të gjitha kostot tjera për riparime dhe mirëmbajtje ngarkohen në pasqyrën e të ardhurave gjatë periudhës financiare në të cilën kanë ndodhur.

Toka nuk është e zhvlerësuar. Zhvlerësimi në pasuritë tjera është bërë me metodën drejtvizore për të alokuar kostot e tyre ose shumat e rivlerësuar të vlerave të mbetura mbi jetën e përdorimit të parashikuar siç vijon:

Ndërtesat	5%
Pajisje montimi dhe makineria	10%
Veturat dhe mjete transportuese	10%
Kompjuterët, Pajisjet e Zyrës,	20%

### **2.3 Dëmet e pasurive jo-financiare**

Pasuritë të cilat kanë jetë përdorimi të padefinuar nuk janë subjekt i zhvlerësimit dhe testohen çdo vit dëmet e tyre. Pasuritë të cilat janë subjekt zhvlerësimi rishikohen për dëmet kurdo që ka indikacione të cilat mund të tregojnë që vlera bartëse e tyre nuk mund të rikuperohet. Humbjet nga dëmet janë njohur në shumën për të cilën vlera bartëse e asetit e tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Vlerë e rikuperimit merret me e larta e vlerës fer të shitjes së atij aseti minus kosto për shitjen apo vlera e kostos historike. Për qëllime të vlerësimit të dëmeve, pasuritë janë të grupuara në nivelin më të ulët prej nga janë identifikuar ndaras rrjedhat e parasë (gjenerimi i njësisve të parasë). Pasuritë jo financiare të cilat janë dëmtuar janë rishikuar për mundësinë e rikthimit të dëmeve në secilën datë raportimi.

### **2.4 Asetet dhe detyrimet financiare**

Asetet dhe detyrimet financiare të prezantuara në bilancin e gjendjes përfshijnë parane, ekuivalentet e parasë, llogaritë e arkëtueshme dhe detyrimet. Kompania klasifikon instrumentet e saja financiare si asete, detyrime apo ekuitet në përputhje me substancën e marrëveshjes relevante. Fitimet apo humbjet e interesit të ndërlidhura me instrumentet financiare të klasifikuara si asete, detyrime apo ekuitet janë të prezantuara si të hyra apo shpenzime, respektivisht.

## **2.Politikat e kontabilitetit (vazhdim)**

Blerjet dhe shitjet e mjeteve financiare njihen në datën e tregtimit – data kur Kompania kryen blerjen apo shitjen.

### **2.5 Vlera fer e aseteve dhe detyrimeve kontigjente**

Vlera bartëse e reflektuar në bilancin përcjellës të parasë dhe ekuivalenteve të parasë, të të arkëtueshmeve dhe detyrimeve afatshkurtra përafron vlerën e tyre reale për shkak të maturimit relativisht të shkurtë të këtyre instrumenteve financiare.

### **2.6 Llogarite e arkëtueshme dhe kërkesat tjera**

Të arkëtueshmet tregtare njihen në fillim në vlerën e tyre reale dhe paraprakisht të matura me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit, minus provizionin për dëme. Provizioni për dëmet e të arkëtueshmeve tregtare është vendosur aty ku ka dëshmi të mjaftueshme që Kompania nuk do të jetë në gjendje ti mbledh të gjitha shumat sipas kushteve origjinale të të arkëtueshmeve. Vështërsit e mëdha financiare të debitorit, me gjasë që debitori të bankrotoj apo të riorganizohet financiarisht, mospagesa apo gabimi në pagesa (që vonohen më shumë se 30 ditë) konsiderohen si indikator që të arkëtueshmet tregtare janë dëmtuar.

Shuma e provizionit është diferenca në mes vlerës bartëse të aseteve dhe vlerës prezente të vlerësuar të rrjedhës së parasë së ardhshme, e zbritur në normën origjinale efektive të interesit. Asetet me maturi afatshkurtër nuk janë zvogëluar.

Vlera bartëse e aseteve zvogëlohet përmes përdorimit të një kontoje për lejim, dhe shuma e humbjes njihet në pasqyrën e të ardhurave në koston e 'shitjeve dhe të marketingut'. Kur një e arkëtueshme tregtare është e pambledhshme, shlyhet kundër kontos për lejimet e të arkëtueshmeve tregtare. Kthimi i pastajshëm i shumave, më parë të shlyera kreditohen kundër 'shpenzimeve tjera operative' në pasqyrën e të ardhurave.

### **2.7 Paraja dhe ekuivalentët e parasë**

Paraja dhe ekuivalentet e parasë përfshijnë paranë në banka dhe në dorë. Për qëllime të pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e parasë përbëhet nga paraja dhe ekuivalentet e parasë të definuar si më lartë.

### **2.8 Stoqet**

Vlera e stoqeve paraqet me të ulëtën e koston apo vlerës neto të realizueshme. Vlera neto e realizueshme është çmimi shitës në rrjedha të zakonshme të biznesit, zvogëluar për koston e kompletimit, marketingut dhe shpërndarjes. Kostoja parimisht është përcaktuar në baza të çmimit mesatar.

## **2.Politikat e kontabilitetit (vazhdim)**

### **2.9 Beneficionet e punëtorëve**

Trepça kontribuon për punëtorët e saj në planet pas pensionimit si janë të përshkruara nga legjislacioni i sigurimit shoqëror i miratuar nga Kuvendi i Kosovës. Kontributet, bazuar në paga, bëhen tek , Trust i Kursimeve Pensionale Kosvës(TKPK). Nuk ka ndonjë detyrim shtesë lidhur me këto plane dhe këto skema konsiderohen si plan i caktuar i kontributeve. Trepça nuk ka beneficione pas pensionimit për punëtorët e tyre. Veç kësaj, Trepça për ish-punëtorët e saj kontribuon në formë të pensioneve të parakohshme dhe stipendioneve një forme e ndihmës solidare për punëtorët e mbetur të papunë.

### **2.10 Llogaritë e pagueshme dhe detyrimet tjera**

Të pagueshmet tregtare dhe të tjera njihen në vlerën reale dhe më pas maten me koston e amortizimit duke përdorur metodën efektive të interesit.

### **2.11 Tatimi në fitim rrjedhës dhe i shtyrë**

Tatimi jepet në pasqyrat financiare në përputhje me rregulloret tatimore të Kosovës që janë aktualisht në fuqi (Ligji nr. 03/L-162 “Mbi tatimin në të ardhurat e korporatave”.

Ngarkesa për tatimin në të ardhura në pasqyrën e të ardhurave për vitin përmban tatimin aktual në të ardhura. Tatimi aktual llogaritet në bazë të profitit të tatueshëm që pritet për vitin duke përdorur shkallët tatimore në fuqi në datën e bilancit të gjendjes. Profiti i tatueshëm ndryshon nga profiti që raportohet në pasqyrën e të ardhurave për shkak se ai nuk përfshin zërat e të hyrave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme apo të zbritshme në vitet tjera dhe më tej ai nuk përfshin zërat që asnjëherë nuk tatimohen ose nuk janë të zbritshëm. Tatimet përveç tatimit në të ardhura regjistrohen si shpenzime operative).

Tatimi i shtyrë njihet në diferencat ndërmjet shumës së bartur të aseteve dhe detyrimeve në pasqyrat e ndara financiare dhe tatimit baze përkatës i përdorur në përlllogaritjen e fitimit të tatueshëm dhe kontabilizohen duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit të gjendjes. Detyrimet tatimore të shtyra në përgjithësi njihen për të gjitha diferencat e përkohshme të tatueshme dhe asetet tatimore të shtyra njihen deri në atë masë që është e mundur që fitimet e tatueshme do të jenë në dispozicion kundrejt të cilit diferencat përkohshme të zbritshme mund të shfrytëzohen.

Shuma e bartur e tatimit të shtyrë-aset rishikohet në secilen datë të bilancit të gjendjes dhe reduktohet deri në atë masë që nuk është më e mundur që fitimet e tatueshme të mjaftueshme do të jenë në dispozicion të lejojnë të gjithë apo një pjesë e aseteve të rikthehet.

Tatimi i shtyrë llogaritet në normën tatimore që pritet të aplikohet në periudhën kur detyrimi është vendosur apo asetit është realizuar. Tatimi i shtyrë ngarkohet apo kreditohet në fitim apo humbje, përveç kur ka të bëjë me artikujt e ngarkuar apo kredituar direkt në ekuitet, në të cilin rast tatimi i shtyra është trajtuar edhe në ekuitet.

**Trepça SHA– Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë**  
**Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020**

Tatimi i shtyrë-aset dhe tatmi i shtyrë-detyrim kompensohet kur ekziston një e drejtë ligjore për kompenzim të tatimit të tashëm-aset kundrejt tatimi të tashëm-detyrim dhe kur ato lidhen më tatimet mbi të ardhurat të vendosura nga i njejti autoritet tatimore dhe Kompania ka për qëllim të vendos tatimin e tashëm-aset dhe tatimin e tashëm-detyrim sipas bazës neto.

## **2.12 Njohja e të hyrave dhe shpenzimeve**

**Të hyrat** njihen kur është mundësia e përfitimeve ekonomike lidhur me rrjedhën e transaksioneve të ndërmarrjes dhe kur shuma e të hyrave mund të matet besueshëm. Të hyrat njihen sipas parimit aktual, në momentin e fitimit.

**Shpenzimet operative** njihen në pasqyrën e të ardhurave në kryerjen e shërbimit ose në datën e origjinës. Shpenzimet njihen sipas parimit aktual, në momentin e ndodhjes.

## **2. Politikat e kontabilitetit (vazhdim)**

### **2.13 Grantet Qeveritare**

Grantet nga qeveria njihen në vlerën reale kur ka një siguri të arsyeshme që grantet do të mirren dhe Kompania do të përbush kushtet e bashkangjitura.

Grantet qeveritare në lidhje me shpenzime janë të shtyera dhe njihen në pasqyrën e të ardhurave në periudhën në të cilën kanë ndodhur shpenzimet për të cilat ka qene i dedikuar granti.

Grantet qeveritare në lidhje me blerjen e pronës, impianteve dhe pajisjeve janë të përfshira në detyrime jo qarkulluese si grant qeveritar i shtyre dhe janë kredituar në pasqyrën e të ardhurave në baza drejt-vizore sipër jetës së pritur për pasuritë e lidhura.

### **2.14 Provizionet**

Provizioni njihet kur Kompania ka një obligim të tanishëm si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe mundësia është që një rrjedhje e burimeve të mishëroj beneficionet ekonomike që do të jenë të kërkuara që të shlyhet obligimi dhe një vlerësim i besueshëm mund të bëhet në shumën e obligimit.

### **2.15 Detyrimet kontingjente**

Detyrimet kontingjente nuk janë njohur në pasqyrat financiare. Ato shpalosen përveç në rastet kur ekziston mundësia që kompania në një të ardhme të ketë dalje të aseteve si pasojë e përbushjes së detyrimeve. Shuma e humbjeve kontingjente njihet si provizion nëse është e

**Trepça SHA– Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë**

**Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020** mundshme që ngjarjet e ardhshme do ta konfirmojnë që, detyrimi ka ndodhur në datën e bilancit të gjendjes dhe mund të behet parashikim i arsyeshëm humbjeve.

## **2.16 Ngjarjet Pasuese**

Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat japin informacione shtesë për pozitën e kompanisë në datën e bilancit të gjendjes (ngjarjet rregulluese) janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas përfundimit të vitit të cilat nuk janë ngjarje që rregullojnë zërat e bilancit të gjendjes për atë datë janë shpalosur në shënime në rastet kur këto shuma janë materiale.

## **2.18 Burimet kryesore të pasigurisë në vlerësim**

Supozimet kryesore në lidhje me të ardhmen, dhe burimet tjera kryesore të pasigurisë në vlerësim në datën e bilancit të gjendjes, të cilat paraqesin një rrezik domethënës për të shkaktuar korrigjime materiale në vlerën e bartur të aseteve dhe detyrimeve brenda vitit financiar vijues, janë diskutuar më poshtë:

### *Jeta e dobishme e Pronave, impianteve dhe pajisjeve*

Sic është shpjeguar në shënimin 3.8 më sipër, Kompania rishikon jetën e dobishme të pronës, impianteve dhe pajisjeve në fund të secilës periudhë të raportimit. Çdo ndryshim në përdorimin e vazhdueshëm të pronave apo faktorëve tjerë mund të ndikojë në jetën e dobishme të aseteve dhe rrjedhimisht mund të ndryshojë në mënyrë të konsiderueshme shumën e bartur të këtyre aseteve.

### *Provizioni për llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe stoqet:*

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën vlerësime për kthimin dhe realizimin e llogarive të arkëtueshme dhe stoqeve. Duke u bazuar në këtë vlerësim, menaxhmenti regjistron një provizion përkatës për dëmtimin e kërkesave dhe shlyerjen e stoqeve. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

### *Vlerësimi i rasteve ligjore:*

Në rrjedhën normale të biznesit, Kompania bën një vlerësim për shumën që nevojiten për shlyerjen e rasteve ligjore sipas udhëzimit të këshilltarit ligjor të Kompanisë. Në bazë të këtij vlerësimi, kompania në përputhje me këtë regjistron provizionin, nëse ka, apo shpalos detyrimin kontingjent. Rezultatet aktuale mund të jenë të ndryshme nga ato të vlerësuara.

## **3. Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të reja dhe atyre të rishikuara për raportim financiar**

**Trepça SHA– Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë**

**Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020**

Kompania ka miratuar të gjitha standardet e reja apo të amandamentuara Kontabël dhe Interpretimet të lëshuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ('BSNK') që janë të obligueshme për periudhën e tanishme raportuese. Çdo Standard apo Interpretim i ri apo i amandamentuar që nuk është ende i obligueshëm nuk është adoptuar.

Organizata ka zbatuar standardet dhe ndryshimet e mëposhtme për herë të parë për periudhën e raportimit duke filluar nga 1 janari 2020:

- Përkufizimi i materialitetit - ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8
- Përkufizimi i një biznesi - ndryshimet në SNRF 3
- Reforma e Referencës së Normës së Interesit - ndryshimet në SNRF 9, SNK 39 dhe SNRF 7
- Korniza Konceptuale e Rishikuar për Raportimin Financiar

Organizata gjithashtu zgjodhi të miratojë herët ndryshimet e mëposhtme:

- Përmirësimet vjetore të standardeve të SNRF-së Cikli 2018-2020.

Ndryshimet e listuara më sipër nuk patën ndonjë ndikim në shumat e njohura në periudhat e mëparshme dhe nuk pritet të ndikojnë ndjeshëm në periudhat aktuale ose ato të ardhshme.

***Standardet e reja dhe të rishikuara të SNRF të lëshuara, por ende jo efektive***

Janë lëshuar disa standarde dhe interpretime të reja të kontabilitetit që nuk janë të detyrueshme për periudhat e raportimit me 31 dhjetor 2020 dhe nuk janë miratuar herët nga Organizata. Këto standarde nuk pritet të kenë një ndikim material në njësinë ekonomike në periudhat aktuale ose të ardhshme të raportimit dhe mbi transaksionet e parashikueshme në të ardhmen.

Trepça SHA- Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë  
Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020

#### 4. Prona, impiantet dhe pajisjet

Përshkrimi	Toka dhe Pasuria e pa zhvlersueshme	Ndërtesat e strukturat ndërtimore	Automjete transportues, Pajisje	Totali
<b><u>Kostot:</u></b>				
Me 01 Janar 2019	148,343,937	372,731	15,815,380	164,532,048
Shtesë	-	-	851,454	851,454
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-
<b>Me 31 Dhjetor 2019</b>	<b>148,343,937</b>	<b>372,731</b>	<b>16,666,834</b>	<b>165,383,502</b>
Shtesë	-	192,182	902,125	1,094,307
Nxjerrje jashtë përdorimit	-	-	-	-
<b>Me 31 Dhjetor 2020</b>	<b>148,343,937</b>	<b>564,913</b>	<b>17,568,959</b>	<b>166,477,809</b>
Zhvlërimi i akumuluar:	-	223,518	13,761,221	13,984,739
Zhvlërimi i viti 2019	-	18,637	751,147	769,784
<b>Me 31 Dhjetor 2019</b>	<b>-</b>	<b>242,155</b>	<b>14,512,368</b>	<b>14,754,523</b>
Zhvlërimi i vitit 2020	-	28,345	911,039	939,385
<b>Me 31 Dhjetor 2020</b>	<b>-</b>	<b>270,500</b>	<b>15,423,407</b>	<b>15,693,908</b>
<b>Vlera neto kontabël 31 Dhjetor 2019:</b>	<b>148,343,937</b>	<b>130,576</b>	<b>2,154,466</b>	<b>150,628,979</b>
<b>Vlera neto kontabël 31 Dhjetor 2020:</b>	<b>148,343,937</b>	<b>294,413</b>	<b>2,145,552</b>	<b>150,783,901</b>

**Trepça SHA- Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë**  
**Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020**  
**5. Stoqet**

	2020	Me 31 Dhjetor 2019
Stoqet e lendes se pare dhe materialit	2,592,001	1,430,250
	<b>2,592,001</b>	<b>1,430,250</b>

**6. Pjesët rezerve / Inventari**

	2020	Me 31 Dhjetor 2019
Stoqet e lendes se pare dhe materialit	2,697,837	
	<b>2,697,837</b>	

**7. Llogarite e arkëtueshme**

	2020	Me 31 Dhjetor 2019
<u>Të arkëtueshmet tregtare</u>		
Të arkëtueshmet tregtare – neto	1,767,098	1,329,188
Të arkëtueshmet e përlllogaritura (TVSH)	612,540	0.00
	<b>2,379,638</b>	<b>1,329,188</b>

**8. Paraja dhe ekuivalentet e parasë**

	2020	Me 31 Dhjetor 2019
Llogaritë rrjedhëse me bankat vendore	197,189	37,236
Paraja në dorë		
	<b>197,189</b>	<b>37,236</b>

## 9. Ekuiteti

### Kapitali dhe rezervat

Paraqet deponimet dhe investimet e bëra nga BK qysh nga viti 2001 e deri më sot. Këto deponime janë bërë nga Buxheti i konsoliduar i Kosovës për investime për ruajtjen e minierave dhe startimin e punës së tyre.

Rezervat janë njohur si rezultat i vlerësimeve të pronës, impiante dhe pajimeve.

## 10. Te hyrat e shtyera nga grantet

	2020	2019
Te hyrat për investime kapitale nga BKK	1,003,082	2,012,346
<b>Me 31 Dhjetor</b>	<b>1,003,082</b>	<b>2,012,346</b>

## 11. Llogarite e pagueshme dhe detyrimet tjera

	2020	Me 31 Dhjetor 2019
Llogarite e pagueshme tregtare	5,236,270	3,625,298
	<b>5,236,270</b>	<b>3,625,298</b>

## 12. Obligimet ndaj të punësuarve

	2020	Me 31 Dhjetor 2019
Të pagueshmet të përlllogaritura	960,624	
Të pagueshmet ndaj tatimit në burim	1,443,523	1,416,031
Të pagueshmet ndaj kontributeve pensionale	1,882,104	
	<b>4,286,251</b>	<b>1,416,031</b>

**Trepça SHA- Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë**  
**Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2020**  
**13. Shitjet**

	Për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor	
	2020	2019
Shitja e mallrave	7,931,459	9,056,244
Shitja e mbeturinave	107,685	
<b>Total shitjet</b>	<b>8,039,144</b>	<b>9,056,244</b>

**14. Te hyrat tjera**

	Për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor	
	2020	2019
Te hyrat nga Subvencionet (BUXHETI I RKS)	6,209,605	3,050,685
Të hyrat nga Qiraja	98,872	291,255
Të hyrat tjera	17,731	13,839
	<b>6,326,208</b>	<b>3,355,779</b>

**15. Kosto e mallit te shitur**

	Për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor	
	2020	2019
<b>KMSH-ja</b>		
Stoqet ne fillim	1,430,250	738,400
Blerjet gjate vitit	2,271,827	2,151,807
<b>Gjithsej stoqet në fillim+blerjet</b>	<b>3,702,077</b>	<b>2,890,207</b>
Stoqet në fund 31.Dhjetor	2,592,001	1,430,250
Pagat e punëtorve në Prodhim	10,403,507	
Energjia Elektrike për Prodhim	1,140,034	
Eksploziv	408,314	
Reagenca	434,165	
Vajra Industriale	52,366	
Karburante	77,914	
Renta Minerare	690,176	
Materialet	1,110,075	
<b>Gjithsej KMSH-ja</b>	<b>14,316,552</b>	<b>1,459,957</b>

**Trepça SHA- Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë**  
**Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020**  
**16.Kostoja e stafit**

	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2020	2019
Pagat e punëtorëve	2,433,614	11,697,971
Kontribute pensionale	121,681	615,683
<b>Total:</b>	<b>2,555,295</b>	<b>12,313,654</b>

**17.Shpenzimet administrative**

	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2020	2019
Shpenzimet e Energjisë Elektrike	248,573	1,510,586
Shpenzimet e Telefonit	6,411	21,727
Shpenzimet tatimit ne prone	25,253	26,848
Shpenzimet e ujit	135,041	147,329
Shpenzimet e Mbeturinave	8,966	8,220
<b>Total:</b>	<b>424,244</b>	<b>1,714,710</b>

**18.Shpenzimet tjera operative**

	Për vitin që përfundon me 31 Dhjetor	
	2020	2019
Shpenzimet për rentën minerare		800,268
Shpenzimet e Ushqimit	417,757	368,857
Shpenzimet e Zhvlerësimit	939,385	769,654
Shpenzimet e transportit të punëtorëve	134,619	214,323
Shpenzimet e Transportit të xehes	79,896	
Shpenzimet përmbaremore	24,533	
Shpenzimet për ndihmë solidarë Punëtorëve	13,894	
Shpenzimet e zyrës	19,995	
Shpenzime për ngarkimin e hirit	7,213	
Shpenzimet e Sigurimeve	12,986	
Shpenzimet e mirëmbajtjes dhe servisimit	13,206	27,535
Shpenzime Bankare	3,458	
Shpenzime për zhdoganim	3,620	
Shpenzime për laborator	4,575	
Shpenzime për KPMM	5,241	2,385
Shpenzime kontabile ( Auditim)	4,220	
Te tjera (grup)	8,581	128,854
<b>Total:</b>	<b>1,693,178</b>	<b>2,311,876</b>

## **19.Shpenzimet financiare**

	Për vitin qe përfundon me 31 Dhjetor 2020	2019
Diferenca negative e kursit te kembimit	(72,327.18)	(7,457)
Shpenzimet e interesit	(34,013.00)	(43,785)
Shpenzimet e interesit nga lizingu financiar	-	(39,614)
	<b>(106,340.18)</b>	<b>(90,856)</b>

## **20.Shpenzimet e tatimit në fitim**

Sipas ligjit për të Ardhurat e Korporatave Nr05/L-29 i hyrë në fuqi duke filluar nga Shtatori 2020, Kompania kërkohet të paguaj tatimin mbi të ardhurat në një normë prej 10% mbi fitimin e tatueshëm, siç është llogaritur në Deklaratën vjetore të tatimit në të ardhurat. Kompania ka ka operuar me humbje prandaj nuk ka kalkuar shpenzimin e tatimit ne fitim.

## **21.Kontingjentet dhe detyrimet**

### **Detyrimet tatimore**

Librat tatimor dhe regjistrimet e Kompanisë për vitin 2020 nuk janë audituar nga autoriteti i tatimor vendor. Detyrimet e tatimeve të kompanisë nuk mund të konsiderohen të përfunduara. Taksa shtesë që mund të dalin gjatë inspektimit nuk mund të vlerësohen me saktësi.

## **22.Risku i menaxhimit financiar**

Menaxhmi i riskut i Kompanisë bartet nga Bordi i Drejtorëve. Menaxhmi i riskut është i fokusuar në pa parashikushmerin e tregjeve dhe mundohet të minimizoj efektet e kundërta mbi performancën biznesore të Kompanisë.

### **22.1 Risku kreditor**

Kompania nuk ka koncetrimet domethënëse të riskut kreditor. Maksimumi i ekspozimit të Kompanisë ndaj riskut kreditor prezantohet nga shuma bartëse e secilit mjet financiar në bilancin e gjendjes.

**Trepça SHA– Minierat me Flotacion Trepça - Stan Tërg; Minierat me Flotacion Kishnicë dhe Artanë**  
**Shënime për Pasqyrat Financiare me dhe për vitin që përfundon me 31 Dhjetor 2020**  
**22.2 Menaxhimi i riskut kapital**

Objektivat e Kompanisë, kur menaxhojn me kapital, janë të ruajnë mundësin që Kompania të vazhdoj vijueshmërinë në mënyrë që të siguroj kthime për aksionaret dhe përfitime për palët tjera të përfshira dhe të mirëmbaj një strukturë optimale të kapitalit që të ulë koston e kapitalit.

Në mënyrë që të mirëmbaj apo rregulloj strukturën e kapitalit, Kompania mund ta rrisë apo kthej kapitalin të aksionaret apo shes pasurit që ti ulë detyrimet.

### **22.3 Vlerësimi i vlerës reale**

Llogarite e arkëtueshme dhe kërkesat tjera të kompanisë, mjetet likuide si dhe detyrimet kanë afat maturimi të shkurtër. Si rrjedhojë e kësaj vlera bartëse korrespondon me vlerën reale të tyre.